REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA LIBRAZHD

### PROCESVERBAL

### KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT-BUXHETIN DHE PAKETËN FISKALE TË BASHKISË LIBRAZHD 2023

I mbajtur më date 16.10.2023, ora 14:00, në dëgjesën mbi projekt-buxhetin dhe Paketën Fiskale të Bashkisë Librazhd për vitin 2023 për Njësinë Administrative Lunik. Takimi u zhvillua në fshatin Lunik.

**Të pranishëm në takim ishin:**

- Kryetari i Bashkisë
- Nenkryetari i Bashkisë
- Drejtor Taksash Lindita Shuli
- Drejtor Bujqesisë Hymi Hoxha
- Drejtor Punëve Publike Erdis Alikoj
- Administratori Njësisë Lunik
- 

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili i njohi pjesëmarrësit me prioritetet e Bashkisë të tilla si:

Ndërhyrje dhe ndërtimi i rrugëve kosrikimi i tyre me çakull në çdo fshat të njësisë administrative Lunik.
Rikonstruksion dhe ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Prevall dhe fshati Lunik.
Ndërtimi i kanaleve vaditëse
Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore Letem
Rikonstruksioni i shkollës në Lunikut.
Pajisja me lodra mjete shkollore në kopshtin për fëmijë

Pas fjalës së përfaqësuesve të tjerë te bashkise, takimi u pasua me sesionin pyetje dhe përgjigje me qytetarët. Kryesisht banorët e zonës kishin ankesa dhe sugjerime që lidheshin me :

Ndërhyrje dhe shtrimi i rrugës Zgosht - Kostenjë
Shtrimi i rrugës në fshatin Prevall
Furnizimi me ujë të pijshëm për banorët e fshatit Prevall, fshatit Zetem dhe fshatit Lunik.
Rikonstruksion i shkollës në Zetmit
Rikonstruksion i Qendrës shëndetësore (Zetem)
Ndërhyrje rikonstruksion dhe ndërtimin e kanalit vaditës

Duke i falënderuar qytetarët për angazhimin dhe përfshirjen e tyre në të mirën e përbashkët të zhvillimit të zonës, përfaqësuesit e Bashkisë garantuan se idetë dhe sugjerimet e pjesëmarrësve në takim do të diskutohen për tu implementuar gjerësisht në projektet në vazhdim.